

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Naxhis Sharani procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të akuzuarve K. S. dhe Sh. K., të dy nga Prizreni, për shkak të veprës penale të kanosjes nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të KP-ës, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.190/15 të datës 16.03.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor në prezencën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren Sahide Sefa, të akuzuarve, me datë 17.01.2017, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të akuzuarve

1.K. S., nga i ati Sh. dhe nëna K. e lindur L., i lindur me datë *data e lindjes...* në Prizren, ku edhe tani jeton, rruga... pa numër, ka të kryer shkollën fillore, bukëpjekës, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

2.SH. K., nga i ati Sh., i lindur me datë *data e lindjes...* në Prizren, ku edhe tani jeton, rruga..., nr..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

Konform nenit 363 par.1 pika 1.1 të KPP-ës.

REFUZOHET AKUZA

Se me datën 31.01.2015, rreth orës 16,00 minuta, në Prizren, rruga ..., seriozisht e kanosin tani të dëmtuarin A. Xh., me armë zjarri, duke i thënë me fjalë "A e din se të vrasim", në atë mënyrë që ditën kritike, i dëmtuari A. Xh. kishte qenë duke e pastruar automjetin e tij para shkollës së mjekësisë në një autolarje, gjersa për një moment kishte vërejtur të pandehurit K. S. dhe Sh. K., të cilët kishin kaluar dy apo re herë për skaj autolarjes me një veturë "Golf 4", ngjyrë hiri metalike, ashtu që të pandehurit fillimisht para shkollës së mjekësisë kishin shkrep me armë zjarri në drejtim të qiellit, e më pas kishin shkuar në drejtim të të dëmtuarit A. Xh., dhe aty i pandehuri K. S. e kanos të dëmtuarin me fjalët "A e din se të vrasim", gjersa në atë moment kishin ndërhyrë punëtori i autolarjes, i cili e kishte larguar të dëmtuarin, ndërsa të pandehurit ishin larguar, me të cilat veprimet të dëmtuarit i kanë shkaktuar frikë dhe ankthe,

Këso dore do të kishin kryer veprën penale të kanosjes në bashkë kryerje nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të KP-së.

Pasi që prokurori i shtetit në shqyrtimin gjyqësor me datë 17.01.2017, është tërhequr nga ndjekja e mëtutjeshme penale kundër të akuzuarve Kastriot Saramati dhe Shani Kurtaj, për shkak

të veprës penale të kanosjes nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të KP-ës, pasi që paraprakisht i dëmtuari A. Xh. gjegjësisht propozuesi e kësaj procedure penale është tërhequr nga ndjekja e mëtutjeshme penale ndaj të akuzuarve K. S. dhe Sh. K., e duke pasur parasysh që procedura penale për këtë lloj të veprës penale fillohet sipas propozimit të dëmtuarit, komform nenit 185 pika 5 të KP-ës,

Shpenzimet e procedurës penale bien në barë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, ka parashtruar aktakuzën PP.nr.190/15 të datës 16.03.2016, kundër të akuzuarve K. S. dhe Sh. K., të dy nga Prizreni, për shkak të veprës penale të kanosjes në bashkë kryerje nga neni 185 par.2 e lidhur me paragrafin 1 e lidhur me nenin 31 të KP-ës,

Pasi që prokurori i shtetit në shqyrtimin gjyqësor me datë 17.01.2017, është tërhequr nga ndjekja e mëtutjeshme penale kundër të akuzuarve K. S. dhe Sh. K., për shkak të veprës penale të kanosjes në bashkë kryerje nga neni 185 par.2 e lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të KP-ës, e duke pasur parasysh që procedura penale për këtë lloj të veprës penale fillon me propozimin e palës së dëmtuar, e duke pasur parasysh që i dëmtuari paraprakisht tërhiqet nga ndjekja e mëtutjeshme penale, prokuroria e shtetit komform nenit të lartë cekur tërhiqet nga ndjekja e mëtutjeshme penale ndaj të akuzuarve K. S. dhe Sh. K., për shkak të veprës penale të kanosjes në bashkë kryerje nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të KP-ës,

Andaj nga të cekurat më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi komform nenit 363 par.1 pika 1.1 të KPP-ës.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e bazoi komform nenit 450 dhe 451 të KPP-ës.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN P.nr.583/2016 me datë 17.01.2017

**Procesmbajtesja
Naxhis Sharani**

**Gjyqtari,
Luan Berisha**

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakenaqr ka te drejtë ankese në afat prej 15 ditesh nga dita e marrjes se njejtës, Gjykates se Apelit ne Prishtinë nëpërmjet kësaj gjykate.